



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 2 nëntor 2015  
Nr. ref.:RK 852/15

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI47/15 dhe KI48/15

Parashtrues

**Beqir Koskoviku dhe Mustafë Lutolli**

**Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjyimit të Dhomës së  
Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC-II-14-0057,  
të 12 marsit 2015**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe  
Bekim Sejdiu, gjyqtar

#### Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë: z. Beqir Koskoviku nga fshati Barilevë, komuna e Prishtinës, dhe z. Mustafë Lutolli nga Prishtina.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC-II-14-0057 (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Ankesave i DHPGJS), i 12 marsit 2015, të cilin parashtruesit e kërkesës e kanë pranuar më 8 prill 2015.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, për të cilin parashtruesit e kërkesës pretendojnë se i ka shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) sipas nenit 46 (Mbrojtja e Pronës).

## **Baza juridike**

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregulloja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 17 prill 2015, parashtruesit i dorëzuan kërkesat në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 2 qershor 2015, me Vendimin GJR. KI47/15, Kryetari i Gjykatës, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Ivan Čukalović (kryesues), Bekim Sejdiu dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 15 qershor 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin e parë për regjistrimin e kërkesës, si dhe një kopje të kërkesës i dërgoi Gjykatës Supreme.
8. Më 10 shtator 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin e dytë për regjistrimin e kërkesës, dhe të njëjtën ditë në pajtim me rregullin 37 (1) të Rregullores së punës, Kryetarja urdhëroi që kërkesat KI47/15 dhe KI48/15 të bashkohen në një të vetme, dhe që gjyqtari raportues dhe Kolegji shqyrtues për të dy rastet (KI47 dhe KI48/15) të jenë të njëjtë ashtu siç ishte vendosur për kërkesën KI47/15.
9. Më 10 shtator 2015, Gjykata njoftoi palët për bashkimin e kërkesës, dhe Gjykatës Supreme i dërgoi kopjet e kërkesave.
10. Më 11 shtator 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës

## **Përmbledhja e fakteve**

11. Më 21 mars 2006, prindërit e parashtruesve B. K. dhe A. L. (tani të ndjerë) kishin parashtruar padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për njohjen e të drejtës së pronësisë mbi parcelat e tokës të cilat gjenden në Fushë-Kosovë. Në të gjitha procedurat e mëtejme gjyqësore, statusi i

trashëgimtarit dhe legjitimiteti i palës për përfaqësim në procedurë lidhur me interesin për parcelën objekt i të cilës ishte padia i është njohur parashtruesve të kërkesës.

12. Parashtruesit pretendonin se në bazë të një marrëveshje mbi arondimin që kishte lidhur me KBI "Kosova Export" (në tekstin e mëtejme: KBI) në vitin 1981, atyre u ishte dhënë më pak sipërfaqe toke se sa që ata i kishin dhënë KBI-së, dhe nëpërmjet padisë synonin të përmbushnin marrëveshjen në tërësi, duke kërkuar të përfitojnë edhe pjesën e mbetur të sipërfaqes tokësore që, sipas tyre, KBI nuk ua kishte dhënë.
13. Më 24 tetor 2006, DHPGJ-ja me Aktvendimin SCC-06-0117 lëndën e ka referuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë.
14. Më 7 tetor 2008, Gjykata Komunale në Prishtinë ka nxjerrë Aktgjykimin C. nr. 2272/06, me të cilin ka refuzuar kërkesëpadinë e parashtruesit, dhe me atë rast ndër të tjera ka konstatuar: "*Sipas vlerësimit të Gjykatës, posedimi i paluajtshmërisë lëndore me vite dhe ndërtimi i objekteve në paluajtshmëri lëndore, nuk mund të paraqet bazë të vlefshme juridike për fitimin e të drejtës së pronësisë mbi bazën e arondimit, në kuptim të dispozitës së nenit 20 par. 2 të Ligjit mbi marrëdhëniet themelore pronësore juridike*".
15. Gjykata më tej ka arsyetuar se "*Kjo formë e fitimit të së drejtës së pronësisë mbi bazën e cituar më lart, do të ishte e pranueshme për gjykatën, nëse palët paditëse do t'i prezantonin gjykatës vendime përkatëse të organit mbi arondimin e paluajtshmërive lëndore. Në këtë gjendje të çështjes, Gjykata gjen se kërkesëpadia e paditësve është e pabazuar dhe të njëjtën si të tillë edhe e refuzoi në tërësi*".
16. Më 22 janar 2009, parashtruesit bashkërisht kanë paraqitur ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Komunale për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
17. Më 8 maj 2013, Gjykata e Apelit në Prishtinë e kishte pranuar dosjen nga Gjykata Komunale dhe nëpërmjet një parashtruese, dosjen së bashku me ankesë e ka dërguar në DHPGJS për kompetencë të mëtejme.
18. Më 16 dhjetor 2014, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së me Aktvendimin C-III-13-0323 e ka mbyllur dosjen dhe ka urdhëruar Zyrën e Regjistrimit që ankesën ta regjistrojë si lëndë për Kolegjin e Apelit, e cila pastaj mori numrin AC-II-14-0057.
19. Më 12 mars 2015, Kolegji i Apelit i DHPGJS me Aktgjykimin AC-II-14-0057, ankesën e parashtruesit e ka refuzuar si të pabazuar dhe ka vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë C. nr. 2272/06, të 7 tetorit 2008.
20. Kolegji i Apelit i DHPGJS në Aktgjykimin e lartpërmendur ndërmjet të tjerave kishte arsyetuar: "*Kolegji i Apelit vlerëson se me Aktgjykimin e ankimuar nuk*

*janë shkelur dispozitat procedurale apo se është vërtetuar gabim gjendja faktike siç pohojnë ankuesit në ankesë”.*

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

21. Parashtruesit e kërkesës kanë pretenduar se Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit të DHPGJS i ka shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe në mënyrë specifike të drejtën e pronës sepse, gjithmonë sipas tyre, pas një procesi të rregullt të arondimit, atyre u është marrë më shumë sipërfaqe toke se sa që u është dhënë.
22. Parashtruesit kanë kërkuar nga Gjykata që të anulojë Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të DHPGJS, dhe lëndën ta kthejë në rivendosje.

### **Pranueshmëria e kërkesës**

23. Për të gjykuar lidhur me kërkesën e parashtruesve, Gjykata paraprakisht vlerëson nëse pala i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
24. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës i cili parasheh:

*“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

25. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) d) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

*“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*

*[...]*

*(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar”.*

dhe rregullin 36 (2) të Rregullores i cili parasheh:

*“(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*

*[...]*

*(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;*

*[...]*

*(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*

26. Ashtu siç u përmend më lart, Gjykata konstaton se parashtruesit pohojnë se me Aktgjykimin e kontestuar, u është shkelur e drejta në mbrojtje të pronës (neni 46 i Kushtetutës) i cili ka këtë përmbajtje:

Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]

1. *E drejta e pronës është e garantuar.*

2. *Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.*

3. *Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë eksproprijimin e pronës nëse ky eksproprijim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave eksproprijohet.*

4. *Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë eksproprijimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.*

5. *Prona intelektuale mbrohet me ligj.*

27. Duke vlerësuar pretendimet e paraqitura në kërkesë Gjykata thekson se parashtruesit vetëm kanë potencuar shkeljen e këtyre dispozitave kushtetuese, por nuk kanë ofruar asnjë provë të vetme për mënyrën dhe natyrën e shkeljes, për rrethanat eventuale në të cilat shkelja e pretenduar ka ndodhur, si dhe nuk kanë shpjeguar cilat janë pasojat kushtetuese të shkeljeve të pretenduara.
28. Gjykata konsideron se vetëm përshkrimi i thjeshtë i dispozitave të Kushtetutës, si dhe pretendimi se ato janë shkelur pa paraqitur fakte për mënyrën e shkeljes, pa përcaktuar rrethanat, pa specifikuar dhe mbështetur me fakte valide veprimet e autoritetit publik që bien në kundërshtim me normat kushtetuese, nuk janë bazë e mjaftueshme për të bindur Gjykatën se ka pasur shkelje të Kushtetutës apo të KEDNJ-së.
29. Gjykata duke bërë shqyrtimin e kërkesës së parashtruesve dhe të fakteve të paraqitura me kërkesën, gjen se në të gjitha fazat e procesit gjyqësor ankesat e parashtruesve kanë qenë të karakterit ligjor, dhe se gjykatat e rregullta u kanë dhënë përgjigjeje adekuate këtyre ankimeve. Pretendimet për shkelje të të drejtave të njeriut të mbrojtura me Kushtetutë, për herë të parë janë ngritur në Gjykatën Kushtetuese.
30. Gjykata më tej konstaton se ajo nuk është gjykatë e faktit, nuk gjykon si gjykatë e shkallës së katërt dhe nuk është thjeshtë një instancë më tepër gjyqësore. Gjykata në parim nuk gjykon faktin nëse gjykatat e rregullta në mënyrë të drejtë dhe të plotë e kanë konstatuar gjendjen faktike, apo nëse si në rastin konkret, nëse arondimi ka qenë proces i rregullt dhe i përmbushur në tërësi sepse kjo është kompetencë e gjykatës së rregullt dhe në fakt, edhe Gjykata Komunale edhe Kolegji i Apelit i DHPGJS këtyre pretendimeve të ngritura u kishin dhënë përgjigje adekuate në aktgjykimet e lartpërmendura.
31. Për Gjykatën janë thelbësore çështjet prej ekzistimit të cilave varet vlerësimi për shkelje eventuale të së drejtave kushtetuese, dhe jo çështjet qartazi ligjore që kryesisht kanë qenë fakte të paraqitura nga parashtruesi (Shih, *mutatis*

*mutandis*, i.a., *Akdivar kundër Turqisë*, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65).

32. Në këto rrethana, Gjykata nuk gjen fakte të jetë shkelur neni 46 i Kushtetutës (Mbrojtja e Pronës) ose që Aktgjykimi i kontestuar të jetë tregues i ndonjë arbitrariteti të dukshëm (Shih Aktvendimin e Gjykatës Kushtetuese, Rasti KI128/12, i 12 korrikut 2013, parashtrues *Shaban Hoxha*, kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 316/2011).
33. Në këto rrethana, Gjykata konstaton se faktet e paraqitura nga parashtruesit në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e të drejtës kushtetuese për mbrojtjen e pronës, andaj gjen se kërkesa duhet refuzuar si qartazi e pabazuar dhe të deklarohet si e papranueshme


### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 36 (1) c), 36 (2) b) dhe d) si dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 11 shtator 2015, njëzëri

### VENDOS


- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

  
Altay Suroy



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

  
Arta Rama-Hajrizi